



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:054363

Datë: 15.11.2019

Numri i dokumentit: 00652729

P.nr.1463/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Fidan Hoxha, me sekretaren juridike Ardijana Reshtani, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. B. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 parag. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1221-2/18, të datës 17.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, nën praninë e Prokurorit të Shtetit Ramadan Koro dhe të akuzuarit, me datë 06.11.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.11.2019 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.B. nga i ati A., dhe e ëma L. e lindur B., i lindur me 05.04.1986, në ...të qytetit , rruga . 24 ne shtetin Zviceran, me banim në fshatin ...ë Komuna e Suharekës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, me profesion ekonomist - financiar, i gjendjes së mirë ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal të pasaportës Zvicerane

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 06.04.2018, në orë të pavërtetuar, në rrugën Prizren- Trepeticë, në Prizren, në rrugën transite të vjetër, gjatë kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme apo ti shkaktoj dëm personit, interesat pasurore, të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, në atë mënyrë që edhe përkundër asaj që i pandehuri ia merr në përdorim- me qira automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., të dëmtuarit Gj.P. dhe me të njëjtin pëson vetë-aksident, i njëjti nuk ia rregullon automjetin e lartcekur apo nuk i përgjigjet për dëmin e shkaktuar, me c'rast të dëmtuarit i shkakton dëm pasuror në vlerë 1973 € (njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 42, 46, 50, 51, 73, 74 dhe nenit 342 parag. 1 të KPRP-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që ia cakton dënimin me gjobë në lartësinë prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj, gjykata dënimin me gjobe do ta zëvendësojë në dënim me burg, konform nenit 46 parag. 3 të KPRK-së dhe

DENIM ME KUSHT

Ashtu që ia vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari Gj.(T. P. nga Gjakova, rruga “ ...”, nr... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1221-2/18, të datës 17.09.2018,, kundër të akuzuarit: A. B. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 parag.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale e ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin i akuzuari pasi që është deklaruar lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1221-2/18, të datës 17.09.2018, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas kësaj aktakuze.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datë 06.04.2018, në orë të pavërtetuar, në rrugën Prizren- Trepeticë, në Prizren, në rrugën transite të vjetër, gjatë kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme apo ti shkaktoj dëm personit, interesat pasurore, të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij,

në atë mënyrë që edhe përkundër asaj që i pandehuri ia merr në përdorim- me qira automjetin e markës “..”, me targa të regjistrimit ..,, të dëmtuarit Gj.P. dhe me të njëjtin pëson vetë-aksident, i njëjti nuk ia rregullon automjetin e lartcekur apo nuk i përgjigjet për dëmin e shkaktuar, me c’rast të dëmtuarit i shkakton dëm pasuror në vlerë 1973 € (njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit A.B. në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilat akuzohet. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij, sjelljet korrekte në gjykatë. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit dhe se me këtë dënim të tillë të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në të ardhmen dënimin të tillë i shqiptuar do të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike është marr konform nenit 463 par.2 të KPPK-së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:054363, 15.11.2019

G j y q t a r i

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:054363
Datë: 15.11.2019
Numri i dokumentit: 00652729